

VENDIM
Nr.934, datë 2.9.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E SHTETEVE, ME NIVEL TË MJAFTUESHËM TË MBROJTJES
SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, janë:
 - a) Shtetet anëtare të Bashkimit European;
 - b) Shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Europiane;
 - c) Shtetet, që kanë ratifikuar konventën nr.108 të vitit 1981 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”, si dhe protokollin shtesë të saj, që garantojnë mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave personale, në përputhje me të gjitha kërkesat e direktivës 95/46/EC, të Parlamentit dhe Këshillit European, datë 24 tetor 1995 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë së të dhënave të tilla”;
 - ç) Shtetet, ku mund të transferohen të dhënat personale, sipas një vendimi të Komisionit të Bashkimit European.
2. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës për nxjerrjen e vendimeve të duhura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha